



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

---

Tiranë, më 01.06.2009

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Rasti: Përfitim kontrolli Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a / Anika Enterprises SA

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i realizuar në bazë të kontratës së shitblerjes së aksioneve, të nënshkruar ndemjet palëve (Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a dhe Anika Enterprises), më datë 6 Mars 2009, me objekt përfitim e plotë të kontrollit në 100% në kapitalin aksionar me të drejtë vote në Bankën e Kreditit të Shqipërisë Sh.a nga shoqëria Anika Enterprises SA.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për Banka e Kreditit të Shqipërisë Sh.a (CBA): veprimtari bankare dhe financiare në tregun bankar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Për Anika Enterprises SA: tregtimi i produkteve të ndryshme, kryesisht karburante dhe nënprodukte të tij, kryesisht në tregun zvicerian.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti i Konkurrencës fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [perqendrim@caa.gov.al](mailto:perqendrim@caa.gov.al)**